

VENDIM
Nr.653, datë 30.9.2004

**PËR LEJIMIN E BASHKISË SË DURRËSIT TË KRYEJË PROCEDURAT E PROKURIMIT
PËR REALIZIMIN E OBJEKTIT PUBLIK “RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT RRUGOR
URA E DAJLANIT-PLEPA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e bashkisë së Durrësit të kryejë procedurat e prokurimit për realizimin e objektit publik “Rikonstruksion i segmentit rrugor ura e Dajlanit-Plepa”, jashtë afateve të parashikuara në paragrafin e fundit të pikës 3.2 të vendimit nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe kryetari i bashkisë së Durrësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano